

Nr. 1450
18.08.2025

fel. Kote
JS

18.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 711/1 prot.

Gjirokastrë, më 14.08.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

- 1.Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 40, datë 31.07.2025 "Për detajimin e objektit 'Blerje mjete transporti për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike', të parashikuar në zërin e shpenzimeve kapitale të buxhetit të vitit 2025", konfirmohet.
- 2.Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 41, datë 31.07.2025 "Për miratimin e projekt dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 (faza II)", konfirmohet.
- 3.Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 43, datë 31.07.2025 "Për miratimin paraprak të planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Kurvelesh, pronë e Bashkisë Tepelenë", konfirmohet.
- 4.Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 44, datë 31.07.2025 "Për miratimin e projektit: 'Ndërtimi i Info-point, vendparkimi dhe aksesit të rrugës në parkim', si projekt prioritar", është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Odise Kote

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNPREFEKTI

Avni Lala

